

VENDIM
Nr.316, datë 30.5.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.244, DATË 7.3.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË MINISTRITË DHE
INSTITUCIONET QENDRORE, PËR VITIN 2007”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve buxhetorë, për vitin 2007, për ministritë dhe institucionet qendrore, është 102 067 veta, për periudhën 1 qershor-dhjetor 2007, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

b) Lidhja nr. 1, “Numri i punonjësve buxhetorë, për vitin 2007”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA